

VENDIM
Nr. 179, datë 27.3.2024

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI
NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË ZONËN KADASTRALE NR. 3038,
FSHATI POVELÇË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DËRMENAS, BASHKIA FIER,
QARKU FIER, NGA SHOQËRIA “ALB SUN ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “ALB SUN Energy” sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

- a) Emri i aplikuesit: Shoqëria “ALB SUN Energy” sh.p.k.;
- b) NIPT/NUIS: L82208032O;
- c) Tipi i centralit: Fotovoltaik;
- ç) Kapaciteti i instaluar: 30 mw;
- d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: Koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaik do të jetë brenda 60 (gjashtëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier;
- e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- ë) Koordinatat e tokës, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe dokumentacionin e projektit;
- g) E drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, e dhënë sipas këtyre rregullave, mund të transferohet te një subjekt i tretë, vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
- gj) Zgjatja e afatit të miratimit të ndërtimit, pajisja me lejen e ndërtimit dhe vënia në operim e impiantit fotovoltaik, dhënë sipas këtyre rregullave, bëhen vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
- h) Shoqëria “ALB SUN Energy” sh.p.k., ose shoqëria për qëllime të veçanta ka detyrimin që:
 - i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;
 - ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
 - iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërmjet shoqërisë “ALB SUN Energy” sh.p.k. dhe ministrisë. Në këtë

kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.


2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria "ALB SUN Energy" sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1

CENTRALI GJENERUES I ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË ZONËN KADASTRALE NR. 3038, FSHATI POVELÇË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DËRMENAS, BASHKIA FIER, QARKU FIER, NGA SHOQËRIA “ALB SUN ENERGY” SHPK



PLANI I VENDOSJES SË STRUKTURËS SHK. 1: 3000

KOORDINATAT

Nr. Pasurie 132/7		Nr. Pasurie 133/2		Nr. Pasurie 133/3		Nr. Pasurie 134/1	
Y	X	Y	X	Y	X	Y	X
4506547,6525	450268,3525	4506389,2574	450393,1494	4506389,2574	450393,1494	4506014,909	450301,4486
4506408,7156	450401,8999	4506247,5688	450527,5764	4506138,3776	450119,9696	4505907,393	450461,0679
4506144,6837	450114,0506	4506325,3124	450606,8796	4506019,9581	450294,0272	4506005,5891	450561,187
4506260,8979	450111,4095	4506463,0929	450473,5195	4506247,5688	450527,5764	4506123,3777	450412,793
4506400,9763	450108,2605						
Nr. Pasurie 134/4		Nr. Pasurie 132/11					
Y	X	Y	X				
4506243,671	450535,3348	4506984,9479	450745,3811				
4506162,0177	450452,4574	4506911,2771	450665,2616				
4506024,6379	450580,5729	4506765,8541	450793,6993				
4506104,4067	450662,459	4506839,0718	450872,5948				